



VENDIM

Nr. 116, Datë 7.10.2013

PËR
NDRYSHIMIN E RREGULLORES “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT
TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NË ZBATIM
TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.05.2003 “PËR
SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE”, TE MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 1, DATE 10.1.2013, TE BORDIT TE KOMISIONEREVE
TE ERE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 19, të Rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 7 .10.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike,

Vendosi:

1. Ndryshimin e Rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari në detyrë

Shkëlqim Bozgo

Teksti i parysimit te rregullores:

Pika a) e nenit 6 shfuqizohet;

Pika c) e nenit 6 ndryshohet si vijon *“të ketë një eksperiencë pune si drejtues ekzekutiv për një periudhë jo më pak se 5 vjecare në sektorin publik apo privat”*;

Pas pikës 7, të nenit 12, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon: *“Brenda nje periudhe 30 ditore nga perfundimi i ketij procesi, administratori i perkohshem njofton ERE-n”*;

Pika 3 e nenit 14, ndryshohet si vijon: *“Harton një protokoll të pagesave ndaj palëve të treta sipas rregullave te Modelit te Tregut, i cili duhet të miratohet paraprakisht në ERE”*;

Pika 1, a), iii, e nenit 17 shfuqizohet;

Fjalja e fundit e pikës 3, të nenit 17 shfuqizohet.